




USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Organi Shqyrtues i Prokurimit: Monitorim dhe rekomandime (janar - qershor 2023)



Organi Shqyrtues i Prokurimit: Monitorim dhe rekomandime (janar - qershor 2023)

Aktiviteti i USAID-it për integritet të komunave të Kosovës

DEKLARATË MOHUESE: Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Lista e shkurtesave

- AK** → Autoriteti kontraktues
- ATK** → Administrata Tatimore e Kosovës
- AUV** → Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
- D+** → Democracy Plus
- KPMM** → Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
- LPP** → Ligji për Prokurimin Publik
- MPB** → Ministria e Punëve të Brendshme
- OE** → Operator Ekonomik
- OShP** → Organi Shqyrtues i Prokurimit
- SHKK** → Shërbimi Korrektues i Kosovës
- SHSKUK** → Shërbimi Spitalor dhe Klinik i Kosovës
- TI** → Teknologji e Informacionit

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje ekzekutive	6
Hyrje	8
1. Numri dhe natyra e vendimeve të OShP-së në gjashtë muajt e parë të vitit 2023.....	9
2. Kohëzgjatja në marrjen e vendimeve dhe pasojat në prokurim publik.....	11
3. Konsistenca në vendimmarrje	12
4. Vonesat në vendimmarrje	13
5. Transparenca	15
6. Angazhimi i ekspertëve, gabimet dhe mostrajtimi i lëndëve në mënyrë adekuate	17
Përfundime.....	20
Rekomandime.....	22

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport monitorues, i zhvilluar nga Democracy Plus (D+) i nënkontraktuar nga aktiviteti i USAID-it për Integritet Komunal në Kosovë (KMI), paraqet një vlerësim të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), organit administrativ që gjykon ankesat, bazuar në vëzhgimet e monitoruesve gjatë një periudhe gjashtëmuajore, nga janari deri në qershor, 2023. Monitoruesit kanë vëzhguar (observuar) vendimet dhe praktikatat e OSHP-së për të vlerësuar paanshmërinë e këtij mekanizmi në trajtimin e ankesave të paraqitura nga palë të ndryshme. Ky raport vë në pah sfida të ndryshme të performancës së OSHP-së në gjashtë mujorin e kaluar, si p.sh mos konsistenca në vendimmarrje, gabimet e ekspertëve, vonesat në vendimmarrje dhe pamjaftueshmëria në transparencë.

Gjatë gjithë periudhës së monitorimit, OSHP nuk ka përdorur metodologji që i referojnë vendimeve të kaluara përgjatë adresimit të ankesave të reja. Miratimi i një metodologjie të tillë do të përshpejtonte procesin e vendimmarrjes dhe do të zvogëlonte gjasat për gabime gjatë trajtimit të ankesave.

Nga prilli 2021 deri në qershor 2022, OSHP ka funksionuar pa bord. Pa këtë mekanizëm të vendimmarrjes, OSHP-ja nuk e kishte të mundur zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Si rezultat, autoritetet kontraktuese ishin të detyruara të ndalonin projektet kapitale të cilat ishin në fazën e shqyrtimit. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, ishin mbledhur mbi 700 ankesa të pazgjidhura që arrinin shumën në mbi 500 milionë euro lidhur me mos marrëveshjet në prokurim publik.

Në qershor të vitit 2022, Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte emëruar pesë (5) anëtarë të ri në bordin e OSHP-së. Mirëpo, gjashtë muaj më vonë, një anëtar i bordit dha dorëheqje, duke e lënë kështu bordin vetëm me katër (4) anëtarë. Efikasiteti i bordit u rrezikua pasi anëtarët e mbetur duhej të menaxhonin ngarkesën e shtuar të punës. Sfida u përforcua më tej nga bartja e 146 ankesave të pazgjidhura nga viti 2022 në gjysmën e parë të vitit 2023. Më tej, pati një rritje të numrit të ankesave gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, të cilat arritën në total 445. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kjo përbënte një rritje prej 203 ankesash. Kapaciteti i OSHP-së për të menaxhuar këtë rritje ishte i kufizuar, veçanërisht me dorëheqjen e një anëtari të bordit.

Gjatë reduktimit të numrit të anëtarëve të bordit dhe grumbullimit të lartë të ankesave të pa adresuara nga viti 2022, OSHP-ja shpesh ka dështuar në respektimin e afatit ligjor për nxjerrjen e vendimeve për ankesa nga Operatorët Ekonomik (OE) gjatë periudhës janar – qershor 2023. Sipas Ligjit për Prokurimin Publik, afati ligjor për marrjen e vendimeve është 34 ditë, por që mund të zgjatet edhe 20 ditë shtesë, në raste të veçanta.

Paneli shqyrtues i OSHP-së përballet me sfida në përdorimin e vazhdueshëm të njohurive të ekspertëve. Përdërisa ata mund të konsultohen me specialistë për rastet teknike të prokurimit, ata jo gjithmonë e integrojnë këtë këshillë në vendimet e tyre. Ndonjëherë ata mbështeten tërësisht në rekomandimet e ekspertëve, por në raste të tjera, ata i anashkalojnë ato. Kjo mos konsistencë vë në pah një fushë kyçe për përmirësim. Të dhënat e gjashtë muajve të fundit konfirmojnë se këto çështje, të evidentuara në gjysmën e parë të vitit 2023, kanë qenë sfida të vazhdueshme për këtë institucion.

Në rastet teknike, veçanërisht në Teknologji të Informacionit (TI) dhe pajisjet mjekësore, bordit të OSHP-së shpesh i mungon ekspertiza. Si rezultat, shumë nga vendimet e tyre mbështeten vetëm në rekomandimet e ekspertëve, të cilat ndonjëherë anashkalojnë ose adresojnë në mënyrë të paqartë pretendimet e palëve. Kjo mbështetje, e kombinuar me mungesën e ekspertëve të specializuar dhe keqpërdorimin e pretendimeve të apelimit, ka ndikuar në rënien e besimit tek institucioni.

Gjatë periudhës së shqyrtimit, monitoruesit vunë re një rënie të konsiderueshme në praktikën e mëparshme të OShP-së për aprovimin e pjesshëm të ankesave. Para këtij ndryshimi, miratimi i pjesshëm i mundësoi OShP-së që të kthejë plotësisht tarifat e ankesës tek Operatorët Ekonomik (OE) edhe nëse vendimi ishte në favor të Autoritetit Kontraktues (AK). Kjo praktikë shpesh i ka shtyrë OE-të të parashtrojnë ankesa pa u menduar mirë, duke e ditur se nuk do të përballen me pasoja financiare. Zvogëlimi i miratimeve të tilla tregon që OShP-ja po miraton një qasje më të balancuar, e cila mund të dekurajojë ankesat joserioze.

Duke pasur parasysh raportimet e mëparshme të shoqërisë civile, monitoruesit në këtë rast raportuan edhe për çështje të transparencës në OShP. Ata nuk kanë publikuar raporte të ndërmjetme apo vjetore në faqen e tyre të internetit, jo të gjitha seancat transmetohen online, disa ankesa të Operatorëve Ekonomik nuk ngarkohen dhe vendimet shpërndahen në formate të skanuara që vështirë lexohen. Këto janë ndër gjetjet kryesore në këtë raport.

Hyrje

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OShP) është organ i pavarur administrativ i cili është përgjegjës për adresimin e ankesave në prokurim publik nga kompanitë e sektorit privat (të njohura si Operatorë Ekonomik) të cilët kanë dorëzuar oferta në përgjigje të tenderëve të prokurimit. Kur një operatorë ekonomik parashton një ankesë në formë të shkruar lidhur me vendimin e marrë nga autoriteti kontraktues, OShP-ja ka mandat të shqyrtojë pretendimet ankimore. Procesi i shqyrtimit kryhet brenda afateve të përcaktuara me ligj për të siguruar zgjidhje në kohë. Pas përfundimit të shqyrtimit, OShP nxjerrë një vendim me shkrim që adreson ankesën specifike (pretendimin e palës) dhe aktivitetin shoqërues të prokurimit.

Ka disa veprime që OShP mund të i ndërmarrë:

Shqyrtimi i ankesave:	OShP vlerëson dhe merr vendime për ankesat e paraqitura nga palët e përfshira në secilin aktivitet të prokurimit.
Vendosja e dënimeve:	OShP-ja ka autoritetin të shqyrtojë dhe zbatojë dënime/dënime (ose të marrë masa të tjera ndëshkuese) për shkelje ose sjellje të pahijshme gjatë prokurimit.
Trajtimi i ankesave jo të plota:	OShP adreson dhe zgjidh ankesat që janë refuzuar ose ato që janë të pa kompletuara.
Menaxhimi i listës së zezë:	OShP vendosë se cilat subjekte shtohen ose largon nga lista e zezë, bazuar në mos përputhshmëri ose çështje tjera.
Lëshimi i gjobave:	OShP vendos gjoba bazuar në specifikat e situatës së prokurimit.

Vendimet e OShP-së janë obligative për të gjitha autoritetet kontraktuese që marrin pjesë në procedura të prokurimit. Këtu përfshihen: ministritë, komunat, ndërmarrjet publike dhe çdo institucion tjetër i cili kryen këto procedura. Pasi OShP-ja nxjerr një vendim, palët kontraktuese duhet ta respektojnë/pranojnë atë menjëherë. Nëse një palë nuk pajtohet me vendimin e OShP-së, ata mund t'i drejtohen gjykatës për rishqyrtim. Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se ekzekutimi i vendimeve të OShP-së nuk shtyhet përgjatë procesit të shqyrtimit nga gjykata. Gjithashtu, palët e pakënaqura e kanë të drejtën të kërkojnë dëmin apo fitimin e humbur siç e parasheh edhe Ligji për Prokurimin Publik (LPP), neni 119¹. OShP-ja ka mandat nga Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë² edhe nga Ligji për Partneritetin Publiko Privat (neni 46)³, për të trajtuar ankesat në përputhje me këto ligje.

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 119 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

2 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Ligji për Prokurim Publik në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

3 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Ligji për Partneritet Publiko Privat, neni 46 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2784>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

1. Numri dhe natyra e vendimeve të OShP-së në gjashtë muajt e parë të vitit 2023

Numri dhe natyra e vendimeve të OShP-së në gjashtë muajt e parë të vitit 2023

272

vendime nga OShP

173

ankesa ende në proces

OShP ka mbajtur

66

seanca dëgjimore

D+ në periudhën 1 janar - 30 qershor 2023 ka monitoruar nxjerrjen e vendimeve nga OShP. Gjatë kësaj periudhe janë marrë 272 vendime, ndërsa në proces kanë mbetur 173 sosh. Gjatë kësaj periudhe, OShP ka mbajtur në total 66 seanca dëgjimore me palët e përfshira në ankesë.

Nëse kategorizojmë të gjitha vendimet gjatë periudhës raportuese, atëherë del se OShP ka marrë:



125

vendime në favor të OE që ka parashtruar ankesë



144

vendime të pafavorshme për OE që ka parashtruar ankesë



Në 51

raste, vendimet e OShP-së kanë devijuar nga rekomandimet e ekspertëve të tyre

125 vendime në favor të operatorëve ekonomikë që kanë bërë ankesë (ankesa të bazuara); 144 vendime kundër operatorëve ekonomikë ankues. Në 51 raste, vendimet e OShP-së kanë devijuar nga rekomandimet e ekspertëve. Ky trend është shqetësues, duke treguar që këshillat e ekspertëve mund të anashkalo-hen. Gjithashtu mund të zvogëlojë besimin në vendimmarrjen e OShP-së dhe të ngrejë pyetje në lidhje me efikasitetin dhe transparencën.

Lidhur me shpërndarjen e ankesave të pranuar kemi:



54

ankesa lidhur me njoftimin për kontratë;



95

ankesa kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit;



280

ankesa kishin të bënin me njoftimet për dhënie të kontratës; dhe



5

ankesa të tjera të fokusuar në kualifikimet e Operatorëve Ekonomik.

2. Kohëzgjatja në marrjen e vendimeve dhe pasojat në prokurim publik

Për dallim nga procedura e ankesës në gjykatë, ku pavarësisht ankesës së operatorit ekonomik, ekzekutimi i vendimit nuk pezullohet, procesi i ankesës së OShP-së çon në pezullimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit⁴ deri në marrjen e një vendimi përfundimtar. Si pasojë, shumë aktivitete të rëndësishme në prokurim publik mbesin të bllokuara deri në marrjen e një vendimi në OShP.

Vonesat e shkaktuara nga ankesat mund të rezultojnë në shtyrje të konsiderueshme të investimeve kapitale, duke ndikuar në projekte me vlerë të konsiderueshme për muaj të tërë. Tenderët që kanë ndikim sezonal, si mirëmbajtja e rrugëve verore dhe dimërore, janë veçanërisht në rrezik për ndikim negativ tek qytetarët. Pezullimi i këtyre aktiviteteve të prokurimit mund të ketë efekte negative në shërbimet publike dhe infrastrukturën, duke theksuar më tej urgjencën e adresimit dhe zgjidhjes së ankesave në kohë dhe me efikasitet.

Për shembull, OShP ka qenë përgjegjëse për vonesën deri në 90 ditë në publikimin e vendimit lidhur me tenderin për “Mirëmbajtjen verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025”. Ministria e Infrastrukturës kishte publikuar njoftimin për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit⁵ i ndarë në disa “Lote”⁶ me datën 11.04.2022. Megjithatë, për shkak të ankesave të njëpasnjëshme nga OE-të publikimi i njoftimit për nënshkrimin e kontratës ishte shtyer për një kohë, dhe u lëshua vetëm gati një vit më vonë, më 4 prill 2023⁷. Koha e tejzgjatuar e shkaktuar nga ankesat ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në proceset e prokurimit, duke rezultuar në vonesa të mëdha dhe ndërprerje të aktiviteteve thelbësore të mirëmbajtjes së rrugëve të planifikuara për ato vite. Më 30 dhjetor 2022, grupi i operatorëve ekonomikë, Kosova Asphalt, AAB Construction, N.N.P.Ndërtimi, Urban O.P, Adnan Bislimi B.l dhe Premium-ks Sh.P.K, kishin parashtruar ankesë në OShP për ‘Lot 3’. OShP-ja kishte nxjerrur vendimin në favor të tyre më 30 mars 2023. Këto vonesa sidomos në aktivitetet e prokurimit të cilat kanë ndikime sezonale, kanë shkaktuar dëme materiale si për operatorët ekonomik të përfshirë, po ashtu edhe për mirëqenien e qytetarëve. Vonesat e tilla mund të prishin operacionet dhe investimet e planifikuara të bizneseve, duke ndikuar si në OE ashtu edhe në publik. Zgjidhja e menjëhershme e ankesave është thelbësore për ekzekutimin pa probleme të projektit dhe për të shmangur pengesat financiare dhe ndërprerjet për të gjitha palët e interesuara.

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 112 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

⁵ Aktiviteti i prokurimit me numër: 205-22-3039-2-1-1 (https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1812209), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

⁶ Lotet në prokurimet publike i referohen një mënyre për të ndarë një kontratë prokurimi në pjesë më të vogla dhe më të menaxhueshme. Duke i ndarë kontratat në lote, një autoritet publik mund ta bëjë kontratën më të aksesueshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), të cilat mund të mos kenë burimet për të ofruar oferta për kontrata më të mëdha. Kjo gjithashtu i lejon autoritetit publik të menaxhojë dhe shpërndajë më mirë burimet

⁷ Njoftimi për kontratë dhe nënshkrim të kontratës (<https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

3. Konsistenca në vendimmarrje

Përgjatë periudhës së monitorimit në gjashtë muajt e parë të vitit 2023, D+ ka identifikuar numër të konsiderueshëm të rasteve në të cilat operatorët ekonomik kanë paraqitur pretendime të ngjashme të bazuara në kornizë ligjore. Përkundër këtyre ngjashmërive, vendimet nga OShP-ja ndryshuan në disa raste njëra nga tjetra, duke treguar nevojën për përmirësim për të siguruar konsistencë të shtuar në proceset e tyre vendimmarrëse. Për shembull, Ligji i Prokurimit Publik (Neni 99), ua ndalon operatorëve ekonomikë të cilët janë në Listën e Zezë, pjesëmarrjen në aktivitetet e prokurimit publik për një periudhë deri në një (1) vit⁸. Megjithatë, ekziston paqartësi nëse ky ndalim zbatohet ekskluzivisht për aktivitetet e prokurimit të publikuara pas vendimit të diskualifikimit, apo nëse shtrihet edhe në aktivitetet e prokurimit të nisura përpara përfshirjes së operatorit në listën e zezë.

Po ashtu, D+ ka vërejtur se vendimet e marra nga OShP-ja lidhur me arsyet e diskualifikimit të OE-ve janë jo konsistente dhe herë pas here tejkalojnë bazën e përcaktuar në ligji. Për shembull, në rastin e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) kundër Matkos Pharm (nr. 274/22)⁹, OShP refuzoi kërkesën e autoritetit kontraktues, me arsyetimin se mos zbatimi i kontratës nga operatori ekonomik nuk është bazë për diskualifikim. Çuditërisht, një muaj më vonë, në rastin NPB v. Bajram Ha. Gashi B.I (nr.409/22)¹⁰, OShP mori vendim për diskualifikimin e operatorit ekonomik për tre (3) muaj, me arsyetimin se ky operator ekonomik, nuk kishte zbatuar kontratën e dhënë nga autoriteti kontraktues.

Përderisa LPP-ja lejon diskualifikimin e OE-ve deri në një vit, nuk arrin të kategorizojë qartë shkeljet dhe periudhat përkatëse të diskualifikimit të tyre. Kjo mungesë qartësie kontribuon në mospërputhjen në vendimet e OShP-së dhe kërkon vëmendje të madhe për të siguruar zbatimin e drejtë dhe uniform të masave të diskualifikimit.

Gjatë vitit 2022, OShP nxori 16 vendime aprovese për Listën e Zezë, duke rezultuar në diskualifikimin e OE-ve nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik. Mesatarisht, këto diskualifikime kanë zgjatur mesatarisht 5.3 muaj. Megjithatë, përgjatë atij viti, , asnjë operatori ekonomik nuk iu shqiptua dënimi maksimal, pra diskualifikimi për një periudhë një (1) vjeçare.

Pavarësisht nga diskualifikimet, vendimet e OShP-së kanë mungesë të konsistencës edhe sa i përket kohëzgjatjes së diskualifikimit për shkelje të ngjashme. Për shembull, në rastin e Komunitetit të Gjakovës, v. Ero Project (Nr.386/22)¹¹, për shkak të mos prezantimit të dokumentacionit nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Gjykata, OShP diskualifikoi operatorin ekonomik për gjashtë (6) muaj nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik. Ndërkohë, në një rast tjetër, i përfshirë Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve dhe Mediatech & Print Sh.P.K. KPMM¹², (Nr.885/21)¹³, OShP-ja ka diskualifikuar operatorin ekonomik për arsyen e njëjtë, por vetëm për tre (3) muaj.

Aplikimi jo konsistent i periudhës diskualifikuese rrit shqetësimin lidhur me drejtësinë dhe transparencën e vendimeve të OShP-së, duke vënë në pah nevojën për rishqyrtim për të siguruar kështu vendime të njëjta dhe uniforme.

8 Rregullorja e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 32. Diskualifikimi i operatorëve ekonomik, pika 1 dhe 2 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=0d49ce49-afc2-eb11-b59b-005056ba09d5>). (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

9 Lista e zezë-Aktiviteti i prokurimit: Furnizimi me materiale mjekësore nga Lista Esenciale, (<https://OSHP.rks-gov.net/sq/Reports/ComplaintByBlackList>) (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

10 Lista e zezë-AP:Renovimii SHFMU "Iliria" (<https://OSHP.rks-gov.net/sq/Reports/ComplaintByBlackList>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

11 Lista e zezë, AP: Ndërtimi I deponive në shkollë (<https://OSHP.rks-gov.net/sq/Reports/ComplaintByBlackList>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

12 KPMM do të thotë Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

13 Lista e zezë, AP: Furnizim me material shpenzues zyrtare (<https://OSHP.rks-gov.net/sq/Reports/ComplaintByBlackList>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

4. Vonesat në vendimarrje

Pas pranimit të ankesës nga operatori ekonomik, OShP është e obliguar ta publikojë vendimin në uebfaqe¹⁴ brenda 34 ditëve. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik¹⁵, eksperti shqyrtues ka 10 ditë kohë për të shqyrtuar ankesën, përderisa autoriteti kontraktues dhe operatori ekonomik kanë katër ditë kohë për të dhënë përgjigje në ekspertizë. Më pas, OShP ka 15 ditë kohë për të marrë vendim, dhe brenda pesë ditëve vijuese duhet ta publikojë vendimin, që gjithsej janë 34 ditë. Në raste të caktuara kur OShP-ja konsideron se një rast është kompleks, e ka autoritetin të shtyjë afatin për nxjerrjen e vendimit për 20 ditë më së shumti. Në këto raste, OShP-ja duhet të ofrojë një arsyetim dhe deklaratë për të arsyetuar zgjatjen.

Gjatë periudhës monitoruese, OShP ka nxjerrur gjithsej 272 vendime mbi ankesat e parashtruara në vitin 2023. Përveç kësaj, ata trajtuan 146 lëndë të bartura, duke i llogaritur në total kështu 418 vendimesh të publikuara nga 1 janari deri më 30 qershor 2023. Fatkeqësisht, çështja e tejkalimit të afatit ligjor për trajtimin e lëndëve vazhdoi gjatë kësaj periudhe raportuese. Nga 272 rastet e publikuara, vetëm 82 ankesa u adresuan brenda afatit ligjor të kërkuar prej 34 ditëve. Një shembull që përkon me vonesa në trajtimin e rasteve është rasti i “EO Pharma Leader LLC” kundër Ministrisë së Shëndetësisë, që kishte të bënte me aktivitetin e prokurimit ‘Furnizim emergjent me Insulina Analoge nga Lista Esenciale’, (lënda 57/23). Megjithëse ankesa është parashtruar me 31.01.2023, vendimi nga OShP-ja nuk ishte publikuar deri me datën 30.06.2023, pra 150 ditë pas dorëzimit të ankesës.

418

vendime të OShP-së gjatë periudhës janar-qershor 2023

Vetëm

82

vendime brenda afatit të përcaktuar me ligj

Konfiskimi i tarifës së ankesës

Çdo operatorë ekonomik që dëshiron ta kontestojë vendimin e autoritetit kontraktues, duhet të paguajë një tarifë për tu ankuar që mund të kushtojë nga 100 deri në 5000 euro. Sipas Rregullores së Punës së OShP-së, kur pretendimet ankimore në një ankesë janë të pabazuara, OShP duhet ta konfiskojë tarifën e ankesës.

Gjatë periudhës së monitorimit nga D+, tarifa e ankesës ndaj operatorëve ekonomikë (OE) është konfiskuar në 97 raste, me shumë totale prej 209,948.33 euro. Tarifa nuk konfiskohet në rastet kur ankesa aprovohet në tërësi apo pjesërisht. Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023, OShP në masë të madhe e ka kufizuar trendin e aprovimit të pjesshëm të ankesave, duke siguruar që shumica e tarifave të konfiskohet. Megjithatë, gjatë periudhës së monitorimit në një rast OShP ka krijuar konfuzion në momentin që i ka kthyer tarifën një operatori ekonomik ankues.

¹⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 114,115,116 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

¹⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 115,116 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

Në rastin e “INFINITT” Sh.P.K ndaj KRU Hidroregjioni Jugor SH.A. lënda 234/23, OShP kishte angazhuar ekspertin shqyrtues për të vlerësuar pretendimet e ankesës.

Pasi eksperti e dorëzoi raportin dhe AK-ja dhe OE që parashtoi ankesën u pajtuan me gjetjet, OShP-ja e konsideroi procedurën e shqyrtimit të përfunduar. Të gjitha palët supozuan se OE që kishte dorëzuar ankesën, është tërhequr nga ankesa dhe për këtë nuk i është konfiskuar tarifa e ankesës¹⁶. Por, sipas Rregullores së punës së OShP-së, në qoftë se ankuesi e tërheq ankesën pas emërimit të ekspertit shqyrtues dhe pranimit të ekspertizës, atëherë bëhet konfiskimi i tarifës në emër të shpenzimeve procedurale¹⁷. Në këtë rast OShP, përmend gabimisht termin ‘tërheqje nga ankesa’ përkundër dëshmive të qarta të një marrëveshjeje të arritur ndërmjet palëve të përfshira.

16 Numri i vendimit 234/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/1875a8e6-92fb-ed11-b5b8-005056ba09d5>), (qasur për here të fundit më 30 qershor 2023)


17 Rregullorja e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 28, pika 1 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=0d49ce49-afc2-eb11-b59b-005056ba09d5>), (qasur për here të fundit më 30 qershor 2023)

5. Transparenca

Faqja zyrtare e internetit e OShP-së¹⁸ e cila ishte lansuar në fund të vitit 2019, vazhdon të përmendet edhe sot si mjet i cili ka rritur në masë të madhe transparencën brenda këtij institucioni.

Tash e gati katër vite, OShP në mënyrë konstante ka publikuar ankesat e plota, raportet e ekspertëve shqyrtues dhe vendimet e panelit shqyrtues të OShP-së. Kjo qasje e ka përmirësuar dukshëm mundësinë për të gjetur rastet në bazë të filtrave të ndryshëm duke iu dhënë përdoruesve mundësinë të kërkojnë me numër të vendimit, numrit të prokurimit apo edhe titullit të tenderit. Po ashtu, në faqen zyrtare gjenden edhe vendimet për operatorët të cilët janë futur në Listë të Zezë¹⁹, duke paraqitur kështu një qasje krahasuese të informacioneve relevante.

Ndonëse kjo faqe ka rritur nivelin e transparencës, e njëjta vazhdon të ketë mangësi. Kjo pasi OShP tash e gati dy vite nuk ka të angazhuar një zyrtarë të TI-së, duke çuar në boshllëqe teknologjike siç është mungesa e ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomikë. Specifikisht, ankesat me numër të protokollit 702/22, 726/22 dhe 676/22 nuk janë të të ngarkuara në ueb faqe. Pa këto dokumente, është e pamundur qasja në ankesat e palëve, duke shkaktuar mungesë të informacioneve të rëndësishme të cilat duhet të adresohen.



Për lëndën 676/22 ueb faqja ofron qasje vetëm për mendimin e ekspertit dhe arsyetimin e vendimit të OShP-së. Ky organ e ka cilësuar si të pabazuar ankesën e operatorit InterLab Sh.P.K. për furnizim me aparatura dhe pajisje mjekësore. Vlera e kësaj kontrate ishte parashikuar të jetë 76,000.00 euro.

Po ashtu, një praktikë e krijuar tash e sa vite, është fakti se vendimet në shumë raste publikohen në format të skenuar, që pamundëson kërkimin në tekst dhe që dokumenti të lexohet nga kompjuteri. Për shembull, në një rast, në faqen zyrtare të OShP-së, në proces paraqitet lënda me numër 618/22 tash e 238 ditë. Çështja u bë edhe më problematike kur u zbulua se lënda, e kategorizuar nga sistemi, i përket "Qendrës së Shëndetit Mendor dhe Shtëpisë Integruese në Bashkësi – Mitrovicë" për aktivitetin e prokurimit: 71206-22-9986-5-2-1. Gjatë shqyrtimit të dokumenteve, u bë evidente se ankesa dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, i takojnë dy lëndëve krejtësisht të ndryshme. Specifikisht, ankesa bënte pjesë në rastin 618/22 lidhur me Kuvendin Komunal të Malishevës për aktivitetin e prokurimit 62500-22-5914-1-1-1 "Furnizim dhe mbjellje e drunjeve dekorativ", kurse ekspertiza e ekspertit i takon Ministrisë së Punëve të

¹⁸ Faqja zyrtare e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OShP), (<https://OShPrks-gov.net/sq>)

¹⁹ Lista e Zezë (<https://OShPrks-gov.net/sq/Reports/ComplaintByBlackList>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

Brendshme, për aktivitetin e prokurimit 214-22-3241-111 (Furnizim me dokumente personale të identifikimit dhe mirëmbajta e sistemeve elektronike).

Gjatë periudhës janar-qershor 2023, OShP-ja e kishte bërë prioritet publikimin e vendimeve në faqen e internetit për operatorët që janë futur në listë të zezë. Në përgjigje të kërkesave nga autoritetet kontraktuese, OShP-ja i ka shtuar pesë operatorë ekonomikë në listë të zezë. Prej tyre, dy operatorëve iu ndalua një vit për të marrë pjesë në aktivitete të prokurimit, ndërsa tre operatorëve iu ndalua për gjatë muaj. Këto veprime janë ndërmarrë për shkak të mosrespektimit apo shkeljes së rregullave dhe rregulloreve të prokurimit publik nga operatorët. Ato shërbejnë si parandalues kundër praktikave të gabuara në të ardhmen dhe theksojnë rëndësinë e respektimit të rregullave të prokurimit.

Me datën 20.10.2022 Komuna e Prishtinës si autoritet kontraktues, ka paraqitur kërkesë në OShP që OE 'Matkos Pharm Sh.PK' të futej në listë të zezë për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme në aktivitetin e prokurimit 'Furnizim me pajisje mjekësore'. OShP-ja e kishte aprovuar kërkesën në pajtim me nenin 99 paragrafi 2 i LPP-së²⁰ duke rezultuar në ndalimin e OE-së nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik për një kohëzgjatje prej një viti²¹, duke filluar nga data 02.05.2023 deri më datën 01.05.2024. Ngjashëm, OShP-ja kishte aprovuar gjithashtu kërkesën e AK 'NH Ibër Lepenci' për OE 'Jakup Neziri B.I-NT Abetarja' për të njëjtën arsye, duke ia ndaluar pjesëmarrjen në aktivitetet e prokurimit publik për periudhën kohore një vit²², duke filluar nga data 08.05.2024. Kërkesa kishte ardhur pasi AK ka pretenduar se OE-ja në fjalë, kishte paraqitur dokumente të rreme ose të falsifikuara në aktivitetin e prokurimit 'Furnizim me material zyrtar'.

Për shkak të pezullimit gjatëmuajor nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik²³, OShP-ja kishte marrë vendim për operatorët 'N.T.P Acvilla', 'N.T.Sh Nazi Travel' dhe 'N.T.Sh 'Bedi Com' bazuar në kërkesën kërkesës e Komunës së Dragashit. Pretendimet ishin se këto OE kishin paraqitur dokumente të rreme ose falsifikuara gjatë pjesëmarrjes në aktivitetin e prokurimit 'Furnizim me lëndë djegëse (dru ahu ose bungu). Periudha e ndalesës ka filluar nga data 08.05.2023 dhe do të zgjasë deri më 08.11.2023.

Një çështje tjetër që lidhet me transparencën ka të bëjë me transmetimin e seancave drejtëpërdrejt përmes platformës Youtube, e cila vazhdon të mbetet problem. Edhe pse gjatë mbajtjes së seancës mbahet edhe procesverbal me shkrim, operatori ekonomik ankues ka mundësi që seancën pas mbarimit ta shoh edhe përmes platformës Youtube, mirëpo ata duhet ta paraqesin një

OShP publikon të gjithë operatorët që i fut në listën e zezë

Seancat dëgjimore u transmetuan pa audio

20 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 99, paragrafi 2 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>). (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

21 Vendimi i OShP-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=50c7b4d7-03ef-ed11-b5b8-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

22 Vendimi i OShP-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=87a71140-1aef-ed11-b5b8-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

23 Vendimi i OShP-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=f5e2e716-05ef-ed11-b5b8-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

kërkesë me shkrim në OShP, për të marr linkun e transmetimit. Mirëpo, në rastet për lëndët 765-816/22 dhe 31/23, seancat e regjistruara ishin vetëm me video, pa audio. Kjo mungesë e zërit komprometon qartësinë dhe saktësinë e informacionit të paraqitur. Në një rast, i përfshirë operatori ekonomik ankues Rahovica Commerce Komerc Sh.P.k, ka kërkuar linkun e transmetimit si dëshmi²⁴ për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025” në vlerë prej 30,921,000.00 euro. Me qasjen në link, OE konstatoi se në incizimin e seancës mungonte audio, duke e bërë atë një dëshmi jo të plotë. Është e rëndësishme të theksohet se qasja në këto transmetime është e mundur vetëm pas parashtrimit të një kërkesë zyrtare në OShP, e cila më pas ofron lidhjen e transmetimit. Megjithatë, sigurimi i përfshirjes së zërit në transmetime është thelbësor për ruajtjen e transparencës dhe lejimin e të gjitha palëve të interesuara që të kenë qasje në informacionin e plotë dhe të saktë gjatë procesit të vendimmarrjes. Një aspekt tjetër thelbësor i sigurimit të transparencës është sigurimi i qasjes së publikut në seancat dëgjimore nëpërmjet transmetimeve të drejtpërdrejta. Prapë, OShP-ja e justifikoi këtë praktikë duke shprehur shqetësime rreth keqpërdorimeve potenciale nga palët e treta. Si rezultat, metoda e vetme për të pasur qasje në transmetime është duke parashtruar kërkesë zyrtare OShP-së, e cila me pas e përcjellë linkun e transmetimit.

Gjatë periudhës së raportimit nga janari në qershor 2023, ka pasur raste kur seancat dëgjimore nuk janë transmetuar fare për shkak të problemeve teknike, siç është raportuar nga OShP-ja. Veçanërisht, rastet 166/23 dhe 153/23 ishin seancat dëgjimore që nuk u transmetuan në platformë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se OShP nuk kishte aplikuar të njëjtën qasje për të gjitha rastet kur kishte probleme me pajisjen që transmeton drejtpërdrejt seancat. Për lëndën 74/23, OShP ka shtyrë seancën shkak i problemeve me këtë pajisje.

²⁴ Aktiviteti i Prokurimit [205-22-3039-2-1-1](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaci-Frm.aspx?id=2382431), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

6. Angazhimi i ekspertëve, gabimet dhe mostrajtimi i lëndëve në mënyrë adekuate

Nëse OShP-ja konstaton se ankesa është parashtruar me kohë nga operatori ekonomik dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1 të Nenit 111²⁵ të LPP-së, do të vazhdojë menjëherë me emërimin e një eksperti për shqyrtim sipas nenit 113 të ligjit në fjalë²⁶.

Sipas nenit 114 të LPP-së²⁷, brenda dhjetë (10) ditësh nga emërimi, eksperti shqyrtues do të shqyrtojë dokumentacionin e prokurimit të autoritetit kontraktues dhe shënimet përkatëse. Nëse konsiderohet e nevojshme ose e përshtatshme, eksperti mund të kryejë intervista me zyrtarë, punonjës ose këshilltarë si nga AK-të ashtu edhe nga pala që ka bërë ankesën. Pas kësaj, eksperti shqyrtues do t'i ofrojë panelit shqyrtues të OShP-së, ankuesit dhe kryesuesit të AK-së një vlerësim me shkrim gjithëpërfshirës, të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Eksperti shqyrtues luan një rol të rëndësishëm në proces duke rekomanduar veprime korrigjuese të nevojshme që duhet të ndërmerren nga autoriteti kontraktues. Këto veprime mund të përfshijnë, sipas nevojës dhe varësisht nga rrethanat: anulimin e aktivitetit të prokurimit, dhënies së kontratës ose rezultati i një konkursi të projektimit, zgjatjen e afatit kohor, ndryshimin ose anulimin e një vendimi të autoritetit kontraktues ose marrjen e çfarëdo masave të tjera të nevojshme për të korrigjuar shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues²⁸.

Caktimi i ekspertëve në OShP bëhet në mënyrë gjysmëautomatike

Caktimi i ekspertëve shqyrtues në OShP bëhej në mënyrë manuale deri në integrimin së fundmi të sistemit elektronik brenda OShP-së. Tani, ekziston një mekanizëm që gjeneron automatikisht rekomandim të emrave të tre ekspertëve për çdo rast që merret në shqyrtim nga paneli shqyrtues. Nga kjo listë, administrata e OShP-së emëron ekspertin më të përshtatshëm për të kryer vlerësimin e nevojshëm. Ky integrim dixhital pasqyron një hap pozitiv drejt thjeshtimit dhe rritjes së efikasitetit të veprimit të OShP-së.

Angazhimi i ekspertëve shqyrtues vazhdon të mbetet problem shqetësues, me disa çështje të vërejtura gjatë periudhës së monitorimit. Disa nga problemet përfshijnë:

- **Trajtimi i pretendimeve:** Në disa raste, ekspertët shqyrtues nuk i trajtuan të gjitha pretendimet e paraqitura, duke çuar në vlerësime të pjesshme dhe mbikëqyrje të mundshme të çështjeve kryesore.

25 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës paragrafi 1. Neni 111 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

26 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës neni 113 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

27 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës paragrafi 1. Neni 114 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

28 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 114, përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

- **Divergjencia nga pretendimet origjinale:** Ndonjëherë, ekspertët shqyrtues trajtuan çështje jo në ank-esën fillestare, duke devijuar fokusin nga shqetësimet kryesore.
- **Tërheqja e ekspertit:** Ka pasur raste në të cilat ekspertët janë tërhequr nga ekspertizat e tyre, duke shkaktuar ndërprerje dhe vonesa në shqyrtim.
- **Vlerësimi i mostrës:** Ekspertët ndonjëherë kanë pasur vështirësi për të vlerësuar siç duhet mostrat nga OE-të, gjë që mund të ndikojë në saktësinë e vlerësimeve të tyre dhe në vendimet e mëvonshme.

Këto çështje të vazhdueshme kërkojnë një vlerësim të plotë të proceseve që kanë të bëjnë me angazhimin dhe performancën e ekspertëve shqyrtues për të siguruar efikasitet, konsistencë dhe besueshmëri më të madhe në procesin e vendimarrjes së OShP-së. Në një rast specifik 714/22²⁹ për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me vaksina” nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe (AUV) me vlerë 250,000.00 euro, ekspertja shqyrtuese ishte përballur me një çështje problematike. Operatori ekonomik (Monuni Sh.P.K.), i cili ka paraqitur ankesën, kishte ngritur një kërkesë (kërkesa nr. 3), duke pohuar se operatori fitues kishte ofruar një vaksinë tjetër (fruthi) në vend të vaksinës së kërkuar kundër gripit të derrit. Këtë pretendim eksperti shqyrtues e kishte cilësuar si të bazuar edhe pse e ishte pasur mundësinë që të kërkonte sqarime nga organi kompetent, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV). Përkundër kësaj mundësie për të marrë njohuri të mëtejshme dhe për të vërtetuar pretendimin, ekspertja vazhdoi ta cilësonte atë si të bazuar pa kërkuar sqarimet e nevojshme. Një vendim i tillë ka ngritur shqetësimet në lidhje me tërësinë dhe saktësinë e procesit të rishikimit.

Në një përgjigje për panelin shqyrtues, Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve në AUV, ofroi informacion në lidhje me aplikimin dhe lëshimin e Fletës Përmbledhëse të Aplikimit për Autorizimin e Tregtimit të Produkteve Medicinale Veterinare, e cila është lëshuar nga AUV më 28 qershor 2022. Sipas vlerësimit të AUV, vaksina e kërkuar ishte për të parandaluar sëmundjen ‘Mortaja klasike e derrave’. Ky vlerësim ishte në kundërshtim me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe pretendimin e operatorit ekonomik ankes Monuni Sh.P.K. lidhur me përdorimin e vaksinave të ndryshme nga operatori fitues. Sqarimi i AUV-it mbështeti pretendimin se vaksina e saktë ishte përdorur me të vërtetë për parandalimin e sëmundjes së Murtagës Klasike të Derrit, duke hedhur poshtë përfundimin e mëparshëm të ekspertit shqyrtues dhe duke e vërtetuar aktivitetin e prokurimit si në përputhje me kërkesat e specifikuar.

Për aktivitetin ‘Furnizim me uniforma për stafin Korrektues’ kompania ‘A&V Collection’ kishte dorëzuar ankesë në OShP ndaj vendimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK). Gjatë seancës dëgjimore të mbajtur nga OShP me datën 1 mars 2023, eksperti shqyrtues kishte dal kundër ekspertizës së tij. Ai pohoi se gjatë hartimit të vlerësimit për lëndën 603/22³⁰, nuk i kishte analizuar fare certifikatat e laboratorit të operatorit ekonomik ankes. Si rezultat, ai kishte ndryshuar qëndrimin e tij, duke hedhur poshtë ekspertizën e dorëzuar. Paneli shqyrtues i OShP-së në këtë rast kishte konstatuar se certifikatat e lëshuara nga laboratorit i certifikuar të shfrytëzuara nga OE ankes, nuk ishin në harmoni me specifikat e dosjes së tenderit të vendosura nga autoriteti kontraktues (Shërbimi Korrektues i Kosovës). Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) kishte iniciuar një aktivitet të prokurimit për furnizim me uniforma për stafin korrektues me një vlerë të parashikuar të kontratës. 1,029,460.95 euro³¹. Ky rast shërben si shembull për rëndësinë e paraqitjes së dëshmi me shkrim edhe nga autoriteti kontraktues edhe nga pala ankesë³² brenda kornizës kohore të caktuar për të mbështetur (mos)pajtimet e tyre me mendimin e ekspertit shqyrtues. Në shumë raste, të dyja palët thjesht shprehin mospajtimin e tyre me vlerësimin e ekspertit, pa paraqitur ndonjë argument thelbësor për të

29 Numri i vendimit 714/22 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/48a3fef3-faa2-ed11-b5b4-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

30 Numri i vendimit 603/22 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/51455c19-f5bb-ed11-b5b5-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

31 Numri i prokurimit 33600-22-5065-1-1-1 (https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2335686), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

32 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 115, paragrafi 2 (<https://gzkrks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

mbështetur qëndrimin e tyre. Për të siguruar një proces të drejtë dhe transparent të rishqyrtimit, sigurimi i provave të bazuara është thelbësor për palët e përfshira në mosmarrëveshjen e prokurimit.

Është e domosdoshme paraqitja e argumenteve të shkruara detajisht, për të mbështetur ose kontestuar konkluzionet e paraqitura nga eksperti shqyrtues. Kjo bëhet veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se paneli shqyrtues jo në secilin rast cakton seancë dëgjimore për palët për të ofruar argumentet e tyre.

Një tjetër lëndë e cila u adresua nga OShP është aktiviteti i prokurimit për furnizim me letër ngjithëse (afishe) të plastifikuara për targat e aluminit nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Kontrata në fjalë kishte vlerë të parashikuar 384,000.00 euro, ndërsa ankesa ishte parashtruar nga OE “CETKOS” L.L.C³³. Operatori ekonomik ankues ishte eliminuar nga gara nga autoriteti kontraktues nën arsyetimin se mostra e letrës e cila ishte dorëzuar nuk i përmbush specifikimet teknike.

Pas marrjes së ankesës, Paneli shqyrtues i OShP-së kishte angazhuar ekspertin për të ofruar një ekspertizë për lëndën në fjalë.

Eksperti gjatë seancës dëgjimore, kishte deklaruar se për pretendimin numër 2, që kishte të bënte me ankesën për mostrat e letrës, letrën ngjithëse e kishte kërkuar nga operatori ekonomik, e jo nga AK-ja. Kjo qasje ngriti shqetësime në lidhje me potencialin për manipulim ose paragjykim. Për të siguruar një proces të drejtë dhe transparent të vlerësimit, eksperti shqyrtues në momentin e vlerësimit të mostrave duhet të kërkojë nga AK-të që të sigurojnë mostrat e dorëzuara nga të gjithë OE-të gjatë aplikimit për aktivitet të prokurimit. Kjo do të eliminonte çfarëdo lloj dyshimi për keqpërdorim dhe do të siguronte që të gjitha mostrat do të vlerësohen bazuar në kritere të njëjta, pa favorizime të operatorve të caktuar.

Gjatë periudhës së monitorimit janar-qershor 2023, OShP-ja numron disa raste ku paneli shqyrtues kishte refuzuar ekspertizën e ekspertëve të angazhuar, duke dal me vendime të veçanta. Këto raste përfshijnë lëndët 655/22, 678/22, 695/22, 696/22, 701/22, 789/22, 17/23 dhe 20/23 kur paneli shqyrtues i OShP-së ka hedhur poshtë të gjeturat e ekspertëve.

Një rast i tillë përfshin aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Barna nga Lista Esenciale për Nevojat e SHSKUK-së” nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës-Lot 1, në vlerë të parashikuar prej 207,000.00 euro. Në këtë rast paneli shqyrtues, kishte hedhur poshtë ekspertizën e dy ekspertëve. Përderisa paneli shqyrtues i gjeti të pranueshme gjetjet e ekspertëve, ata nuk u pajtuan me rekomandimin për anulimin e të gjithë aktiviteti³⁴. Paneli shqyrtues ka theksuar ndjeshmërinë e këtij aktiviteti të prokurimit, siç është përojellë në letrat e AK-së në OShP, duke theksuar nevojën thelbësore për furnizimin e produktit ‘Fentanyl’, i cili është jetik për funksionimin e sallave operative”.

Vlen të theksohet se përkundër shkresave të AK-së, OShP-së i janë dashur 56 ditë për të nxjerrë vendim për këtë rast pasi operatori Liri-Med ka dorëzuar ankesën. Kjo vonesë mund të kishte implikime të rëndësishme, duke marrë parasysh rëndësinë e furnizimeve mjekësore në kohë në mjediset kritike të kujdesit shëndetësor.

Në
51
raste, vendimet
e OShP-së kanë
devijuar nga
rekomandimet e
ekspertëve të tyre

33 Numri i vendimit 91/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/f75e57ad-c8f0-ed11-b5b8-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

34 Numri i vendimit 20/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/97f51de0-7bc1-ed11-b5b5-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2023)

Përfundime

PROBLEMET KRYESORE ME TË CILAT PO VAZHDON TË PËRBALLET OSHP-ja JANË:

Vonesat në vendimmarrje

Tejkalimi i afatit ligjor për publikimin e vendimeve vazhdon të jetë njëri ndër problemet kryesore nga ana e OSHP-së. Ky problem jo vetëm që ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të prokurimit publik, por gjithashtu minon besimin e palëve të interesuara në aftësinë e OSHP-së për të zgjidhur ankesat në kohë dhe në mënyrë të drejtë.

Një nga pasojat kryesore të këtyre vonesave është zgjatja e aktiviteteve të prokurimit publik. Kur ankesat nuk adresohen menjëherë dhe vendimet nuk publikohen brenda afatit të përcaktuar, pengohet rrjedha e proceseve të prokurimit. Pasiguria me të cilën përballen të gjitha palët e përfshira, duke përfshirë autoritetet kontraktuese dhe OE, mund të rezultojë në vonesa të projekteve, pengesa financiare dhe humbje të mundësive të zhvillimit ekonomik.

Vonesat mund të jenë veçanërisht të dëmshme në rastet kur aktivitetet e prokurimit kanë implikime sezonale ose të ndjeshme ndaj kohës. Për shembull, tenderët që lidhen me mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dimrit ose verës, ose furnizimi me mallra për ngjarje të caktuara, mund të kenë mundësi të kufizuara. Kur vendimet vonohen, qëllimi i këtyre aktiviteteve mund të bëhet i vjetëruar ose më pak i rëndësishëm, duke ndikuar negativisht në efikasitetin dhe kosto-efektivitetin e projekteve.

Për më tepër, tejkalimi i afatit ligjor prek integritetin dhe reputacionin e OSHP-së si organ i pavarur dhe i paanshëm përgjegjës për zgjidhjen e kontesteve të prokurimit. Palët e interesuara, duke përfshirë OE, AK-të dhe publikun e gjerë, mund ta perceptojnë OSHP-në si joefikase ose të paafte për të përmbushur mandatin e saj, duke çuar në mungesë besimi në këtë institucion.

Mungesa e konsistencës në vendime

Mos konsistenca në vendime vazhdon të jetë një sfidë e rëndësishme për OSHP-në dhe implikimet e saj shkojnë përtej sferës së OE. Kjo çështje ka një ndikim të thellë në besueshmërinë e OSHP-së si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të prokurimit publik. Mospërputhja e vendimeve ngre shqetësime për drejtësinë dhe paanshmërinë e procesit të rishikimit.

Për OE-të, përballja me rezultate të paparashikueshme dhe të ndryshme mund të çojë në pasiguri dhe zhgënjim. Mungesa e qartësisë në vendimet e OSHP-së e bën të vështirë për operatorët të kuptojnë kriteret e përdorura për të vlerësuar ankesat e tyre. Kjo pasiguri mund t'i dekurajojë OE-të në adresimin e ankesave legjitime, pasi ata mund ta perceptojnë procesin si të kotë ose të njëanshëm.

Për më tepër, mospërputhja lëkund besimin e publikut në aftësinë e OShP-së për të mbështetur parimet e transparencës dhe llogaridhënies në prokurimin publik. Një perceptim i njëanshmërisë ose vendimmarrjes arbitrare mund të lëkund besimin e qytetarëve në integritetin e sistemit të prokurimit, i cili është thelbësor për promovimin e konkurrencës së ndershme dhe për të siguruar që paratë e taksapaguesve po përdoren në mënyrë efektive.

Angazhimi i ekspertëve

Funksionimi efektiv i OShP-së mbështetet shumë në ekspertizën e ekspertëve të saj shqyrtues, veçanërisht në fusha të specializuara si TI dhe mjekësia. Për të siguruar që OShP-ja mund të trajtojë ankesat komplekse dhe teknike me saktësi dhe aftësi, është thelbësore që të adresohet çështja e angazhimit të ekspertëve dhe zgjerimit të ekspertizës.

Mungesa e transparencës

Transparenca në punën e OShP-së ka nevojë për përmirësim. Kjo përfshin transmetimin e të gjitha seancave dëgjimore në internet, mbajtjen e linqeve për akses publik, publikimin e ankesave dhe vendimeve në një format të lexueshëm në faqen zyrtare të internetit dhe sigurimin e dokumentacionit të duhur.

Rekomandime

BAZUAR NË GJETJET E RAPORTUARA KËTU, D+ REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME PËR TË PËRMIRËSUAR PERFORMANCËN E OShP-SË:

1

Përmirësimi i databazës së të dhënave:

OShP-ja duhet t'i japë prioritet rekrutimit të një specialisti të TI-së për të përmirësuar bazën e të dhënave të tyre. Ky përmirësim synon thjeshtimin e kërimit të vendimeve për çështje të veçanta dhe promovimin e një vendimmarrjeje të qëndrueshme. Një infrastrukturë e fuqishme e TI-së do të optimizojë menaxhimin e rasteve, do të sigurojë ruajtjen dhe rikthimin e sigurt të dokumenteve dhe përfundimisht do të ngritë standardet e transparencës së OShP-së, aksesin e të dhënave, duke çuar në transparencë të përmirësuar dhe operacione të thjeshta.

2

Publikimi i vendimeve të pritshme:

Të përpilohet një listë e kërkesave të zakonshme nga OE dhe të publikohen në mënyrë proaktive vendimet e pritshme për këto kërkesa. Kjo do t'i sigurojë OE-së njohuri të avancuara dhe potencialisht do të zvogëlojë numrin e ankesave. OShP-ja duhet të punojë drejt vendosjes së kritereve të mirëpërcaktuara dhe uniforme për vendimmarrje në raste të ndryshme. Ky standardizim do të thjeshtojë procesin, duke promovuar një qasje më të qëndrueshme të vendimmarrjes dhe do të sigurojë drejtësi në adresimin e ankesave të marra.

3

Përzgjedhja e automatizuar e ekspertëve:

Të modifikohet sistemi për të gjeneruar emrin e një eksperti të vetëm në vend që të ofrohen tre rekomandime. Ky rregullim do të rrisë transparencën dhe do të shmangë favorizimin. Duke pasur parasysh se OShP-ja mbështetet shumë në ekspertizën e ofruar nga eksperti, ky rregullim është edhe më kritik.

4

Vlerësimi i performancës së ekspertëve:

Të vlerësohet rregullisht performanca dhe cilësia e punës së ekspertit për të siguruar profesionalizëm dhe paanshmëri, veçanërisht në rastet që përfshijnë performancë joadekuate. OShP-ja duhet të ketë prioritetë rekrutimin e ekspertëve, veçanërisht në fushën e TI-së dhe pajisjeve mjekësore, për të adresuar rastet me saktësi dhe efikasitet më të lartë. Zbatimi i programeve të trajnimit dhe mundësive për mundësi zhvillimi profesional mund të rrisë nivelin e ekspertizës brenda OShP-së dhe të sigurojë konsistencë më të mirë. Përveç kësaj, angazhimi i vazhdueshëm me palët e interesuara, duke përfshirë OE, AK-të dhe organizatat e shoqërisë civile, mund të promovojë transparencën, si dhe të mbledhë reagime relevante për funksionimin më të mirë të OShP-së.

5

Eliminimi i praktikës ‘Ankesa pjesërisht e bazuar’:

Të inkurajohen ekspertët shqyrtues që të mos i kategorizojnë rastet si pjesërisht të bazuara, pasi që kjo praktikë e vështirëson procesin e vendimarrjes për panelin shqyrtues.

6

Publikimi i gjobave të vendosura ndaj autoriteteve kontraktuese:

OShP të bëjë publike listën e autoriteteve kontraktuese që janë gjobitur për shkak të mos respektimit të vendimeve të OShP-së. Kjo masë do të dekurajonte shkeljet e ardhshme.

7

Aksesi në dokumente:

Të ruhen të gjitha dokumentet thelbësore, duke përfshirë vendimet, apelimet dhe raportet e ekspertëve, në një format elektronik të lexueshëm (të lexueshëm nga kompjuteri) për akses të përshtatshëm publik. Ky hap do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien. Përveç kësaj, publikimi i raporteve gjithëpërfshirëse vjetore që përmbajnë informacione në lidhje me autoritetet kontraktuese që nuk kanë respektuar vendimet e OShP-së, performancën, statistikat për pjesën e mbetur, rastet e reja dhe rezultatet e tyre, do t’u mundësojë palëve të interesuara të vlerësojnë efektivitetin dhe efikasitetin e OShP-së.

8

Masat e transparencës:

Të bëhet transmetimi i drejt-përdrejtë i të gjitha seancave dëgjimore, të jenë të qasshme linqet për seancat e mbajtura në çdo kohë, publikimi i ankesave dhe vendimeve të bëhet në një format të qartë dhe të lexueshëm në faqen zyrtare të internetit pasi do të rrisë transparencën dhe qasjen e publikut në procedurat e OShP-së.

Me zbatimin e këtyre rekomandimeve, OShP-ja mund të rrisë transparencën, besueshmërinë dhe efektivitetin e saj në trajtimin e ankesave të prokurimit publik, duke kontribuar përfundimisht në një sistem më të përgjegjshëm dhe efikas të prokurimit publik në Kosovë.

